



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Rruga: "Durrësit", Nr. 23, AL- 1001, Tiranë – SHQIPËRI

[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Tel: 00 355 4 222 260

Nr. *4346* Prot.

Tiranë, më *22.07*.2009

**URDHËR**

Nr. *227*, datë *22.07*.2009

**PËR**

**AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "UNIVERSITETIT POLIS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Akreditimit,

***URDHËROJ :***

1. Akreditimin institucional të shkollës së lartë universitare private "Universiteti Polis"
2. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë në "Arkitekturë Urbanistikë", me kohëzgjatje normale 4 vite, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë (DNP), në "Arkitekturë Urbanistikë", e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
3. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë në "Planifikim Urban", me kohëzgjatje normale 4 vite, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë (DNP), në "Planifikim Urban", e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
4. Akreditimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë në "Arkitekturë dhe Dizain Urban", me kohëzgjatje normale 5 vite dhe me 300 kredite, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND), në "Arkitekturë dhe Dizain Urban", e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
5. Akreditimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë në "Planifikim dhe Menaxhim Urban", me kohëzgjatje normale 5 vite dhe me 300 kredite, në përfundim të të cilit lëshohet



**ministra e arsimit dhe shkencës**  
ministra e sësërmes  
[www.mash.gov.al](http://www.mash.gov.al)

Urdhër për akreditimin

Faqe 1 nga 2

Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND), në “Planifikim dhe Menaxhim Urban”, e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.

6. Të gjithë studentët e rinj që do të regjistrohen nga viti akademik 2009-2010 e në vazhdim mund të ndjekin vetëm programet e studimit, të përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij urdhri, sipas programeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë universitare private “Universiteti Polis” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional dhe të programeve të studimit të përcaktuara në pikën 4 dhe 5 të këtij urdhri pas 6 vitesh, sipas përcaktimit në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe Shkolla e lartë universitare private “Polis”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**



**FATOS BEJA**

